



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 2, datë 30. 03. 2009

MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES, PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË QYTETIN E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 32, shkronja k të ligjit 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); të ligjit Nr.8653, datë 31.7.2000 për “Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; të nenit 85 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); të nenit 4 të kreut të II-të, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 për “Transportet rrugore”, (i ndryshuar); të VKM-së nr.325, datë 19.3.2008 për “Miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të udhëzimeve të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 1649, datë 16.08.1999 mbi “Plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve” (i ndryshuar); nr. 20, datë 10.10.2007 për “Modelet e licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar); nr. 12, datë 19.07.2007 për “Përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e bllokut të udhëtimit dhe regjistrin të shërbimit taksi” (i ndryshuar); nr. 15, datë 24.07.2007 për “Kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar); të ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në qytetin e Tiranës.

2. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 67, datë 20.12.2005 për “Kriterin e vitit të prodhimit të mjeteve taksi”, revokohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë, Drejtoria e Kontrollit të Territorit Urban, të marrin masat për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R